

VENDIM
Nr. 95, datë 8.4.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 8.4.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi	kryetare
Denar Biba	zv/kryetare
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysenm Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtar

Në mbështetje të nenit 21, pika 25, nenit 23, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lefterije Luzi

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 21, pika 25, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton këtë

RREGULLORE

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i rregullores

Ky akt detajon rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e KQZ-së duke përfshirë:

- a) mënyrën e ushtrimit të kompetencave të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KQZ-së;
- b) të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të KQZ-së;
- c) rregullimin e marrëdhënieve të adminis-tratës me anëtarët e KQZ-së;
- d) procedurat për thirrjen, njoftimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të KQZ-së gjatë periudhës zgjedhore dhe asaj jozgjedhore;
- e) procedurat e vendimmarrjes në KQZ-së;
- f) të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në KQZ;
- g) procedurat e vendimmarrjes për adminis-trimin e financimeve të aktivitetit të KQZ-së, si dhe
- h) rregullat mbi krijimin, administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit në KQZ.

Neni 2

Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e KQZ

1. Detyrat e KQZ-së burojnë nga, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nga ligje të veçanta.
2. Veprimtaria e KQZ-së bazohet në parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, pavarësisë, profesionalizmit, paanësisë dhe transparencës.

PJESA II
FUNKSIONIMI I KQZ-së
KAPITULLI I PARË
PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT

Neni 3

Përbërja e KQZ-së

1. KQZ është organ kolegjial, i përbërë nga 7 anëtarë, të zgjedhur sipas procedurave të parashikuara në nenet 14, 15 dhe 16 të Kodit Zgjedhor.
2. Zgjedhja e zëvendëskryetarit të KQZ, bëhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 16 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 32, pika 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Kompetencat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KQZ-së

1. Kryetari i KQZ-së ka këto kompetenca:
 - a) drejton mbledhjet e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ në marrëdhënie me institucionet e tjera;
 - b) kryen funksionet e drejtuesit administrativ të institucionit. Në zbatim të kompetencave, sipas kësaj shkronje, kryetari i KQZ-së nxjerr urdhra të brendshëm vetëm në bazë dhe për zbatim të vendimeve të KQZ-së.
2. Zëvendëskryetari i KQZ-së kryen detyrat e Kryetarit në mungesë të tij.
3. Kryetari i ushtron kompetencat në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni së bashku me Zëvendëskryetarin. Të gjitha aktet e nxjerra në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni nënshkruhen edhe nga zëvendëskryetari, përndryshe janë të pavlefshme. Bëjnë përjashtim rastet kur kryetari ose zëvendëskryetari nuk ushtrojnë funksionet për arsye objektive. Do të konsiderohen të tilla mungesa për shkaqe të justifikuara, bojkoti për të marrë pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e KQZ-së, apo refuzimi i paargumentuar ligjërisht, për të nënshkruar aktet e nxjerra në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 5

Të drejtat e anëtarëve të KQZ-së

- Të drejtat e anëtarit të KQZ-së burojnë nga neni 17 i Kodit Zgjedhor dhe ligje të tjera. Anëtari i KQZ-së për ushtrimin e funksioneve të veta ka dhe këto të drejta:
- a) t'i kërkojë informacion dhe mbështetje administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin të vërë në dispozicion fotokopje të çdo dokumentacioni të depozituar në KQZ, sa herë që kërkohet prej tyre;
 - b) t'i sigurohet nga Sekretari i Përgjithshëm kushtet për zhvillimin e mbledhjeve të KQZ-së;
 - c) të njihet me rendin e ditës së mbledhjes së KQZ-së dhe me materialet përkatëse:
 - i) jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën deri 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve;
 - ii) jo më vonë se 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën 1 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve;
 - iii) sipas rastit jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për ditën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit, për çdo zonë zgjedhore.

Neni 6

Detyrat e anëtarëve të KQZ-së

- Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtari i KQZ-së, krahas detyrimeve të parashikuara në nenin 17 të Kodit Zgjedhor, duhet:
- a) të informojë KQZ-në, në rastet kur merr pjesë në veprimtari me cilësinë e anëtarit të KQZ-së;
 - b) të informojë KQZ-në, në rastet kur ushtron veprimtari sipas nenit 21, pika 3 e Kodit Zgjedhor;
 - c) të mbajë qëndrime që janë në përputhje me vendimet, udhëzimet apo akte të tjera të KQZ-së, kur përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët, publikun dhe median;
 - d) të zbatojë dhe të respektojë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim dhe sjellje.

KAPITULLI I DYTË ADMINISTRATA E KQZ-SË

Neni 7

1. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, KQZ-ja ka administratën e vet të përhershme të përbërë nga nëpunës të shërbimit civil dhe punonjës të tjerë.
2. Administrata e KQZ-së përbëhet nga personel, i cili rekrutohet në përputhje me ligjin nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar ose me Kodin e Punës.
3. Organika e administratës, numri i personelit dhe struktura e pagave përcaktohen me vendim të KQZ-së.
4. Në periudha të veçanta, KQZ mund të rekrutojë personel shtesë me kontratë me afat të caktuar.

Neni 8

Funksionimi, detyrat dhe të drejtat e administratës së KQZ-së përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së KQZ-së.

KAPITULLI I TRETË PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE

Neni 9

Regjistrimi në KQZ i përfaqësuesve të partive politike

1. Përfaqësuesit e partive politike dhe zëvendësit e tyre, caktohen si dhe kanë të drejta dhe detyrime, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor.
2. Të dhënat për përfaqësuesit e partive politike mbahen në një regjistër të posaçëm, i cili administrohet nga protokoli. Një kopje e këtij regjistri ju dërgohet anëtarëve të KQZ-së si dhe të gjitha drejtorive.
3. Përfaqësuesit e partive politike pajisen me dokumentin përkatës të identifikimit, sipas modelit të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së.

Neni 10

Akti i përfaqësimit

Përfaqësuesit e partive politike në KQZ, dhe zëvendësit e tyre duhet të depozitojnë në KQZ, autorizimin e nënshkruar nga kryetari i partisë.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat

1. Përfaqësuesit e partive politike që marrin pjesë në mbledhjen e KQZ-së kanë të drejtë të diskutojnë, japin mendime të paraqesin kërkesa dhe propozime në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë rregullore. Ata nuk mund të delegojnë të drejtën e tyre të përfaqësimit apo dhe të drejta të tjera tek persona të tjerë.
2. Në rast se, në mbledhje të KQZ marrin pjesë njëkohësisht përfaqësuesit e partive politike dhe zëvendësit e tyre, të drejtën e fjalës sipas nenit 22, pika 4 të Kodit Zgjedhor e ka vetëm njëri prej tyre.
3. Në çdo rast çështja që diskutohet sipas nenit 22, pika 4 e Kodit Zgjedhor, duhet të ketë lidhje me zgjedhjet dhe veprimtarinë e KQZ.
4. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së iu dërgon njoftimin për datën, orën dhe rendin e ditës përfaqësuesve të partive parlamentare, si më poshtë:
 - a) jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën deri 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve;
 - b) jo më vonë se 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën 1 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve;
 - c) sipas rastit jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për ditën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit, për çdo zonë zgjedhore.
5. Përfaqësuesve të partive parlamentare ju vihet në dispozicion duke ua dërguar pranë selive të partive, apo duke ja venë në dispozicion në ambientet e KQZ-së, në çdo rast materialet e rendit të ditës së mbledhjes së thirrur. Përfaqësuesit e partive të tjera kanë të drejtë t'i tërheqin ato pranë Sekretarit të

Përgjithshëm ose Protokollit.

6. Përfaqësuesit e partive politike kanë të drejtë të marrin një kopje të akteve të KQZ-së pranë zyrës së Protokollit.

7. Përfaqësuesit e partive politike me kërkesë me shkrim, mundet të kërkojnë dokumente pranë zyrës së protokollit ose arkivit. Në këto raste Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, cakton orar në të cilin, përfaqësuesit e partive politike mundet të tërheqin dokumentin të cilin kanë kërkuar, pranë zyrës së protokollit ose arkivit.

PJESA III MBLEDHJET E KQZ-së

KAPITULLI I PARË MBLEDHJET E KQZ-SË JASHTË, GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE DHE NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Neni 12

Thirrja, njoftimi dhe përgatitja e mbledhjes

1. Mbledhjet e KQZ-së thirren, njoftohen dhe përgatiten sipas përcaktimeve të bëra në nenin 22 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

2. Akti i thirrjes së mbledhjes hartohet në tre ekzemplarë dhe përmban datën, orën, rendin e ditës, si dhe nënshkrimet përkatëse sipas rastit të thirrësve të mbledhjes. Ky akt dërgohet për regjistrim në zyrën e Protokollit.

3. Në rastet kur mbledhja nuk është thirrur nga kryetari i KQZ-së sipas nenit 22, pika 1 e Kodit Zgjedhor, kopje të aktit të thirrjes së mbledhjes, i dërgohen paraprakisht këtij të fundit për dijeni.

4. Akti i thirrjes së mbledhjes, menjëherë pas regjistrimit në protokoll, i dërgohet sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili merr masa për njoftimin e zv/kryetarit, anëtarëve si dhe të përfaqësuesve të partive politike.

5. Kopje e aktit të thirrjes së mbledhjes vendoset në vendin e posaçëm në hyrje të KQZ-së, si dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së në internet.

6. Mbledhjet e KQZ-së, thirren si më poshtë:

a) jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën deri 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve

b) jo më vonë se 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën 1 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve

c) sipas rastit jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për ditën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit, për çdo zonë zgjedhore.

Neni 13

Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së KQZ-së, nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar

1. KQZ mblidhet si rregull çdo ditë gjatë periudhës nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Gjatë kësaj periudhe, mbledhjet e KQZ mbyllen me përcaktimin e rendit të ditës për mbledhjen pasardhëse.

2. Në raste të veçanta, gjatë periudhës 1 muaj para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ mund të mblidhet dy herë në ditë.

3. Procedurat për thirrjen, njoftimin dhe përgatitjen e mbledhjes në periudhë nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, u përmbahet sa është e mundur procedurave në nenin 12 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI I DYTË MATERIALET E MBLEDHJES SË KQZ-SË

Neni 14

Përmbajtja e dosjes së materialeve për mbledhjen e KQZ-së

1. Për çdo çështje që do të shqyrtohet në mbledhjen e KQZ-së, materiali përkatës si rregull duhet të përmbajë:

- a) relacionin shpjegues;
- b) materialin mbështetës;
- c) si rregull, projekt-aktin;
- d) sipas rastit, lidhje ose materiali bashkëlidhur;
- e) propozimet për ndryshime apo shtesa nga subjektet zgjedhore, nëse ka të tilla, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje

2. Në relacionin shpjegues përfshihen arsyet dhe/ose shkaqet përse kërkohet shqyrtimi i çështjes përkatëse në rendin e ditës, qëllimi dhe sipas rastit vlera e shpenzimeve financiare që kërkon zbatimin e këtij akti. Në materialin mbështetës përfshihen, akte, raporte, informacione, etj, të cilat mbështesin relacionin shpjegues.

Neni 15

Dorëzimi në KQZ i propozimeve për ndryshime dhe shtesa në projektaktet dhe materialet e mbledhjes

1. Përfaqësuesit e partive politike kanë të drejtë të paraqesin propozime me shkrim apo me gojë, për ndryshime apo shtesa në projektaktet që do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së KQZ.

2. Propozimet për ndryshime dhe shtesa të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kur janë me shkrim, duhet të depozitohen zyrtarisht në zyrën e protokollit të KQZ.

3. Përveç rasteve kur propozimi është vetëshpjegues, ai mund të shoqërohet me një shënim shpjegues për të lehtësuar të kuptuarit apo sqaruar më mirë qëllimin e propozimit.

Neni 16

Përgatitja e materialeve për mbledhjet që thirren nga të paktën dy anëtarë të KQZ

1. Në rastin kur mbledhja thirret nga dy anëtarë të KQZ-së, materialet e mbledhjes përgatiten nga thirrësit e mbledhjes, në bashkëpunim me administratën e KQZ-së e cila është e detyruar të bashkëpunojë për të respektuar afatet e njoftimit të mbledhjes sipas pikës 2, të nenit 12 të kësaj rregulloreje.

2. Materialet e mbledhjes dhe akti i thirrjes së saj, i hartuar sipas parashikimeve të nenit 12, pika 6 të kësaj rregulloreje, menjëherë pas regjistrimit në protokoll, i dërgohen sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, për plotësime dhe rregullime të mundshme të karakterit ngushtësisht formal. Pas kësaj, ky i fundit merr masa për njoftimin e anëtarëve të tjerë dhe të përfaqësuesve të partive politike.

Neni 17

Përgatitja e materialeve të mbledhjes të KQZ-së

1. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së është përgjegjës për përgatitjen e materialeve për mbledhje të KQZ, në rastin e çështjeve/akteve, të cilat janë të përfshira në programin e punës së KQZ, ose rrjedhin nga zbatimin e vendimeve apo udhëzimeve të KQZ-së. Në këtë rast sekretari i Përgjithshëm konsultohet paraprakisht me Kryetarin e KQZ-së.

2. Përgatitja e materialeve për mbledhje sipas pikës 1 të këtij neni ndjek këtë procedurë:

a) kur struktura përkatëse për përgatitjen e akteve nuk është përcaktuar në programet e punës së KQZ, kryetari cakton drejtorinë, e cila në bashkëpunim me sekretarin e Përgjithshëm do të përgatisë paraprakisht relacionin dhe projektaktin;

b) drejtoria përkatëse sipas rastit, ua përcjell për mendim materialin e mësipërm, drejtorive të tjera të KQZ-së;

c) secila prej drejtorive jep me shkrim mendimin e saj në lidhje me sa i kërkohet;

d) drejtoria përgjegjëse në çdo rast konsultohet me drejtorinë juridike për bazën ligjore ku mbështetet projektakti;

e) në çdo rast relacioni i projektaktit duhet të nënshkruhet nga të gjithë hartuesit e tij;

f) Sekretari i Përgjithshëm, kur është e nevojshme, bën rregullimet e duhura, ose plotëson dosjen me materiale të tjera mbështetëse.

3. Sekretari i Përgjithshëm dorëzon tek kryetari, dosjen me dokumentacionin e përgatitur sipas pikës 2 të

këtij neni.

4. Në mungesë të sekretarit të Përgjithshëm, materiali përkatës dorëzohet tek kryetari dhe paraqitet në mbledhje të KQZ-së nga drejtoria ose sektori që e ka hartuar.

5. Në të gjitha rastet sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për shpërndarjen e kopjeve të materialeve të mbledhjes anëtarëve të KQZ-së.

Neni 18

Dosja e materialeve të mbledhjes

1. Për çdo çështje të rendit të ditës përgatitet një dosje e veçantë nga sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, e cila, përveç materialeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 14 të kësaj rregulloreje, përmban pasqyrën e të dhënave mbi çështjen.

2. Dosja me materialet e mbledhjes, sipas pikës 1, neni 14 të kësaj rregulloreje, mbahet sipas rastit nga drejtoria që ka përgatitur projektaktin, deri në miratimin me vendim nga KQZ-ja. Në rastin kur materialet janë përgatitur nga anëtarë të KQZ-së, dosja përkatëse mbahet nga sekretari i Përgjithshëm. Pas miratimit me vendim dosja depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Akteve dhe Dokumentacionit (Protokoll).

Neni 19

Ruajtja dhe administrimi elektronik i materialeve të mbledhjes

1. Sekretari i Përgjithshëm së bashku me strukturat përkatëse drejton procesin për ruajtjen dhe administrimin e materialeve të mbledhjes në formatin elektronik, në versionin përfundimtar, përpara se të shqyrtohen në mbledhjen përkatëse të KQZ-së.

2. Në çdo rast së bashku me njoftimin për mbledhjen, në faqen e KQZ-së në internet, publikohen edhe materialet e mbledhjes.

3. Materialet e mbledhjes ruhen në një bazë elektronike të dhënash, për jo më pak se 12 muaj.

KAPITULLI I TRETË MBLEDHJET E KQZ-SË

Neni 20

Zhvillimi i mbledhjes

1. Anëtarët e KQZ-së paraqiten në datën dhe orën kur është thirrur mbledhja, në sallën e mbledhjeve të KQZ-së.

2. Në fillim të mbledhjes, drejtuesi i saj, deklaron rendin e ditës dhe anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

3. Në periudhë 1 muaj para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, ajo shtyhet për jo më shumë se 12 orë.

4. Jashtë periudhës së përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, ajo shtyhet për jo më vonë se pas tre ditësh.

5. Mbledhjet e KQZ-së janë kurdoherë publike dhe zëdhënësi i KQZ-së merr masa për njoftimin e mediave dhe pasqyrim e mbledhjeve në to.

Neni 21

Rregulla të përgjithshme për pjesëmarrësit në mbledhje

1. Përpara fillimit të mbledhjes, sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së merr masa për caktimin e vendeve të pjesëmarrësve në mbledhje.

2. Gjatë zhvillimit të mbledhjes ndalohet ndërprerja e fjalës së folësit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë rregullore.

3. Ndalohet gjithashtu marrja e fjalës pa leje, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit.

4. Pjesëmarrësit në mbledhjet e KQZ-së duhet të respektojnë rregullat e etikës dhe të komunikimit.

Neni 22

Masat për shkelje të rregullave në zhvillimin e mbledhjes së KQZ-së

1. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për mbajtjen e rregullit dhe siguron respektimin e kësaj rregulloreje.

2. Drejtuesi i mbledhjes hap, pezullon, mbyll dhe drejton diskutimet në mbledhjen e KQZ-së.

3. Në rastet kur cenohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, drejtuesi i saj vendos ndërprerjen e seancës, për 10 deri në 30 minuta.

4. Në rast se përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, cenojnë rregullat për zhvillimin e mbledhjeve, drejtuesi i mbledhjes i tërheq vëmendjen secilit që shkakton një gjë të tillë.

5. Në rast se ndonjë nga personat e tjerë të pranishëm në mbledhjet e KQZ-së prishin rregullin, drejtuesi i mbledhjes mund të vendosë largimin e tij nga salla e mbledhjeve të KQZ-së.

6. Në rast se zhvillimi i mbledhjes është i pamundur, KQZ me votim dhe pa debat vendos shtyrjen e saj.

Neni 23

Diskutimi për çështje jashtë rendit të ditës

1. Në fillim të mbledhjes, pasi ka prezantuar rendin e ditës verifikon kuorumin e nevojshëm të anëtarëve të KQZ, sipas nenit 22, pika 5. Pasi kryen këto veprime, drejtuesi i mbledhjes, në bazë të nenit 22, pika 4 e Kodit Zgjedhor, pyet pjesëmarrësit nëse kanë diskutime për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës duke regjistruar sipas rastit folësit.

2. Pasi mbyllet regjistrimi i folësve, drejtuesi jep fjalën sipas radhës së regjistrimit.

3. Folësit e regjistruar kanë të drejtë të flasin vetëm një herë dhe për një kohë jo më të gjatë se pesë minuta.

4. Pas përfundimit të diskutimeve të regjistruara, asnjë prej pjesëmarrësve nuk mundet të kërkojë dhe të marrë fjalën për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

Neni 24

Radha e shqyrtimit të çështjeve në mbledhje

Radha e shqyrtimit të çështjes në mbledhjen e KQZ-së është ajo e përcaktuar në rendin e ditës.

KQZ me konsensus mund të vendosë për ndryshimin e radhës së shqyrtimit të çështjeve në rendin e ditës.

Neni 25

Pjesëmarrësit që kanë të drejtë të diskutojnë në mbledhjet e KQZ

Në mbledhjet e KQZ-së kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e KQZ-së, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ ose zëvendësit e tyre dhe me leje të drejtuesit të mbledhjes edhe administarta e KQZ-së pjesëmarrëse në mbledhje si dhe persona të tjerë që lidhen me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve.

Neni 26

Shqyrtimi në mbledhjet e KQZ

1. Shqyrtimi i çështjes fillon me paraqitjen e relacionit nga sekretari i Përgjithshëm dhe/ose drejtorja që ka përgatitur çështjen, ndërsa në rastin kur projektakti është përgatitur nga të paktën dy anëtarë të KQZ-së, relacioni paraqitet prej tyre. Relacioni paraqitet në mënyrë të përmblodhur.

2. Pas relatimit, pjesëmarrësit kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të kërkuar sqarime, për elemente të ndryshme të relacionit.

3. Pjesëmarrësit që dëshirojnë të bëjnë pyetje shprehin paraprakisht kërkesën për të bërë pyetje.

4. Drejtuesi i mbledhjes iu jep pjesëmarrësve, me radhë, të drejtën për të bërë pyetje.

5. Gjatë dhënies së përgjigjeve ndalohen ndërprerjet e fjalës të atij që përgjigjet dhe komentet.

6. Me miratimin e drejtuesit të mbledhjes pjesëmarrësit mund të bëjnë edhe një pyetje tjetër si reagim për përgjigjen e marrë.

Neni 27

Votimi në parim dhe hapja e diskutimeve

1. Pas procedurës së parashikuar në nenin 26, drejtuesi propozon miratimin në parim të projektaktit nëse akti që do të miratohet është akt normativ dhe sipas rastit hap diskutimin në themel për çështjen.

2. Drejtuesi i mbledhjes fton të pranishmit, duke filluar nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, të diskutojnë në lidhje me çështjen.

Neni 28

Koha në dispozicion për diskutimet

1. Koha në dispozicion për të diskutuar për çështjen, për përfaqësuesit e partive politike dhe çdo të

interesuar tjetër pjesëmarrës në mbledhje, është 8 minuta, e cila pasqyrohet në monitorët e sallës së mbledhjes.

2. Për të njëjtën çështje, pjesëmarrësit kanë të drejtë të rimarrin fjalën vetëm një herë për një kohë, si rregull, jo më shumë se 3 minuta, por gjithsesi jo më shumë se koha e diskutimit të parë.

3. Në përfundim të diskutimeve të përfaqësuesve të partive politike dhe pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje, diskutojnë anëtarët e KQZ-së. Pas diskutimit të fundit të kryetarit të KQZ-së, bëhet mbyllja e diskutimeve.

Neni 29

Mbyllja e diskutimeve

1. Mbyllja e diskutimeve bëhet nga drejtuesi i mbledhjes, me pëlqimin e anëtarëve të KQZ-së.

2. Të drejtën e propozimit për mbylljen e diskutimeve e ka çdo anëtar i KQZ-së.

3. Pas mbylljes së diskutimeve drejtuesi i mbledhjes fton diskutantët të paraqesin propozimet e tyre.

4. Para votimit të çdo propozimi anëtari i KQZ-së ka të drejtën e diskutimit për të, për jo më shumë se 5 minuta.

Neni 30

Regjistrimi i mbledhjeve të KQZ-së

1. Të gjitha mbledhjet e KQZ-së regjistrohen elektronikisht me zë ose edhe me figurë, si dhe mbahet procesverbal ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

2. Procesverbali i mbledhjes i pazbardhur dhe i mbajtur i përmbledhur me dorë nga stenografi, dorëzohet menjëherë në Zyrën e Ruajtjes dhe Administrimit të Dokumentacionit në KQZ.

3. Regjistrimet e mbledhjes së KQZ-së ruhen në Arkiv, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore dhe në akte të tjera.

4. Gjatë periudhës zgjedhore, anëtarëve të KQZ-së në pamundësi të vënies në dispozicion të procesverbalit të zbardhur të mbledhjes, përpara nënshkrimit të aktit iu vihet në përdorim regjistrimi elektronik i mbledhjes, në të cilën është diskutuar materiali apo akti, nëse kjo kërkohet prej tyre.

KAPITULLI I KATËRT

VENDIMMARRJA

Neni 31

Votimi i propozimeve për projektaktet që shqyrtohen në mbledhje të KQZ-së

1. Në shqyrtimin e projektaktit, KQZ-ja vendos me votim të veçantë për përmbajtjen e çdo neni ose pjese të tij, sipas rastit.

2. Në çdo rast, varianti i projektaktit do të votohet, vetëm pasi të jenë votuar propozimet përfaqësuesve të partive politike dhe anëtarëve të KQZ-së, sipas radhës së propozimit të tyre.

3. Drejtuesi i mbledhjes në përfundim të votimit shpall rezultatin e votimit.

Neni 32

Votimi

1. Votimi në KQZ-është i hapur. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose me deklaram.

2. Votimi bëhet i fshehtë vetëm në rastet e parashikuara me ligj.

3. Votimi i fshehtë bëhet sipas kësaj procedure:

a) KQZ-ja miraton me vendim fletën e votimit të përgatitur nga sekretari i Përgjithshëm.

b) Anëtarët e KQZ-së votojnë sipas rendit alfabetik të emrit.

c) Shënimi në fletën e votimit bëhet vetëm në dhomën e fshehtë.

ç) Fleta e votimit hidhet e palosur në kutinë e votimit, në mënyrë që të mos lejojë identifikimin e votës.

4. Anëtari i KQZ-së voton “pro” ose “kundër”, abstenimi nuk lejohet. Nëse kërkon, anëtari ka të drejtë të shpjegoj votën “kundër”.

Neni 33
Forma e aktit

1. Akti i miratuar nga KQZ, sipas shtojcës 1, pjesë e kësaj rregulloreje, është i formës së shkruar dhe si rregull përmban:

- Stemën e Republikës së Shqipërisë;
- Emrin e institucionit;
- Titullin e aktit;
- Objektin e aktit;
- Bazën ligjore;
- Pjesën arsyetuese, sipas rastit;
- Pjesën urdhëruese;
- Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në votim;
- Logon e KQZ-së;
- Numrin, datën dhe orën e miratimit.

2. Akti nënshkruhet nga anëtarët që kanë votuar.

3. Çdo akt mund të shoqërohet, sipas rastit, me mendim paralel dhe/ose mendim pakice.

Neni 34
Nënshkrimi i aktit

1. Drejtoria që ka përgatitur projektaktin, bën arsyetimin e tij dhe ua kalon për nënshkrim anëtarëve të KQZ-së.

2. Anëtarët e KQZ-së e nënshkruajnë aktin dhe në rast se nuk janë dakort me pjesën arsyetuese të tij mund të paraqesin mendim paralel.

Neni 35

1. Akti hartohet në 3 kopje. Dy kopje nënshkruhet sipas pikës 2 të nenit 34 të kësaj rregulloreje dhe 1 kopje pasi ka përfunduar procedura e mësipërme, nënshkruhet vetëm nga sekretari i Përgjithshëm.

2. Nënshkrimet e anëtarëve të KQZ-së vendosen edhe në lidhjet bashkëngjitur aktit të miratuar.

KAPITULLI I PESTË
SHQYRTIMI I ANKIMEVE ZGJEDHORE

Neni 36

1. Procedurat e paraqitjes, relatimit dhe shqyrtimit të kërkesës ankimore bëhen sipas përcaktimeve të nenit 124-144 të Kodit Zgjedhor.

2. Për çdo kërkesë ankimore të regjistruar, KQZ-ja cakton me short një anëtar si relator. Relatori bën verifikimin e elementeve të formës sipas nenit 126 dhe elementeve të nenit 130 të Kodit Zgjedhor dhe prezanton verifikimin në mbledhjen e KQZ-së jo më vonë se 24 orë nga regjistrimi i kërkesës ankimore.

3. Vendimet që merr KQZ-ja për shqyrtimin e kërkesave ankimore arsyetohen nga relatori.

PJESA IV
FINANCIMET DHE BUXHETI I KQZ-së

Neni 37

1. KQZ-ja administron fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Struktura e shpenzimeve miratohet me vendim të KQZ-së.

2. Buxheti miratohet me vendim të KQZ-së sipas afatit të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Neni 38

1. Çështjet që lidhen me financimin e subjekteve zgjedhore miratohen me vendim të KQZ-së.

Neni 39

1. KQZ mund të përfitojë donacione të huaja të ndryshme në bazë të legjislacionit në fuqi, me kusht që të mos cënohen pavarësia dhe autoriteti i tij.

Neni 40

Administrimi i telefonisë celulare në përdorim të anëtarëve KQZ-së rregullohet me urdhër të veçantë të Kryetarit, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

PJESA V DOKUMENTACIONI I KQZ-së

Regjistrimi i akteve dhe i dokumentacionit në KQZ

Neni 41

1. Regjistrimi i akteve dhe dokumenteve bëhet në regjistrat e poshtëshënuar:

- a) Regjistër i korrespondencës;
- b) Regjistër i vendimeve të KQZ-së;
- c) Regjistër i udhëzimeve të KQZ-së;
- ç) Regjistër i kërkesave ankimore;
- d) Regjistër i vëzhguesve;
- dh) Regjistër i urdhrave të Kryetarit;
- e) Regjistër i urdhrave të prokurimeve.

2. Administrimi i regjistrave bëhet nga Zyra e Protokollit.

Neni 42

Rregullorja e KQZ-së, miratuar me vendimin nr. 26, datë 03.03.2005 “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, shfuqizohet.

PJESA VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 43

Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Shtojca 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M
TITULLI I VENDIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës04.2015, me pjesëmarrjen e:

Emri	MBIEMRI-	Kryetare
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtare
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT:

BAZË LIGJORE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Demokratike, si dhe dëgjo i diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Pjesa arsyetuese

PËR KËTO ARSYE,

Baza ligjore për marrjen e vendimit

VENDOSI:

Dispozitivi

Hyrja në fuqi.

E drejta e ankimit

Emri	MBIEMRI-	Kryetare
Emri	MBIEMRI-	Zv/Kryetar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar
Emri	MBIEMRI-	Anëtar